



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Adresa:Fushe-Arrez,Prefektura Shkoder,Tel:027123131,Email:info@bashkiafushearrez.gov.al

Procesverbal -Tipi i kontrates - Sherbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashk dokumentat e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS - “Sherbim dhe mirembajtje ne pyjet e Bashkise Fushe-
Arrez”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
77200000-2 Sherbime pyjore

VLERA E FONDIT LIMIT – 1 883 333 (nje milion e teteqind e tetedhete e tre mije e treqind e tridhjet e tre) **leke pa TVSH.**

Në bazë të nenit 77, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 41 , autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Fushë-Arrëz**, ka hartuar procesverbalin për argumenimin dhe miratimin e specifikimeve tenike dhe kriterëve për kualifikimin për procedurën e sipercituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- a) **Kopjet e certifikuara të bilanceve për vitin 2022** të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse e të konfirmuara nga ky autoritet.
- b) Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitetet për vitin **2022**.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Ligjin nr. 160/2020 "Per prokurimin publik" neni 77, pika 3, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 43 pika 4., sipas shtojces 7 pika 1 germa dh tek DST.

Përcaktimi i vitit të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Per te provuar pervojen e meparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses te nje ose disa kontratave per shërbimet e mëparshme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të madhe se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 55, pika 4 germa b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet te disponoje License me Kodin III.7.A, me nenkategori-Sherbime te ekspertizes dhe/ose profesionale lidhur me pyje dhe/ose kullota.

2.3.3 Operatori Ekonomik per zbatimin e kontrates duhet te disponoje minimum 2 (dy) motosharra ne pronesi ose perdorim.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e zerave të preventivit të publikuar në SPE.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të disponojë kontratë pune me një Inxhinier Pyjesh i cili të jetë i pajisur me diplomën perkatese si dhe Certifikatë leshuar nga Drejtoria e Mbrojtjes dhe Trajtimit të Pyjeve për Sherbime profesionale për zbatime dhe Sherbime profesionale në projektme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 77, pika 4, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 41 pika 4 germa b.

Inxhinier Pyjesh, i cili do të jetë dhe kryetar i grupeve respektive të punës.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 10 (dhjete) punonjës për zbatimin e kontratës, nga të cilët minimalisht një prej tyre të disponojë Leje për përdorimin e pajisjeve nën presion të leshuar nga IQT.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 41 pika 4 germa c. Me anë të këtij kriteri kërkohet që OE të kenë stafin teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Numri i punonjësve të kërkuar është vendosur bazuar në preventiv, në të cilin parashikohen zëra shërbimesh si: pastrim pyjesh, grumbullim i mbeturinave në togje.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikatat si mëposhte:

- **OHSAS 18001:2007** ose **45001:2018** mbi “Shëndetin dhe sigurimin në punë” të leshuar nga Institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim .
- **ISO 14001:2018** mbi “Sistemet e menaxhimit të ambientit” të leshuar nga Institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr.160, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 77, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 44 pika 3.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë, standartet për shëndetin dhe sigurinë në punë, si dhe standartet e menaxhimit të mjedisit. Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se: operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së punimeve objekt kontrate, në mënyrë të qëndrueshme, ku referuar natyrës së punimeve që kërkohen të kryhen, njësia e prokurimit ka kërkuar certifikatat e mësipërme për vërtetimin se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto punime.

Certifikatë ISO 45001-2018 “Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë”, mundëson që çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.